

VENDIM
Nr. 400, datë 9.6.2022

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE “ERSEKA SOLAR PARK 1” DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN E ERSEKËS,
BASHKIA KOLONJË, QARKU I KORÇËS, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I
SHOQËRIVE “FAVINA” SHPK, “FAVINA 1” SHPK DHE “M&K ENERGY TRADING
CO” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 1” dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., me elementet si më poshtë vijon:

a) emrin e aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k.;

b) numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:

“Favina” sh.p.k.: J64104078V,

“Favina 1” sh.p.k.: K54624001I,

“M&K Energy Trading Co” sh.p.k.: M04516001I;

c) tipin e centralit: fotovoltaike;

ç) kapacitetin e instaluar: 20 mw;

d) afatin e pritshëm të vënies në punë: koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaike do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

dh) vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës;

e) afatin e operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ose institucione të tjera të autorizuar kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) e drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 1” dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 20 mw, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë për qëllime të veçanta mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin, që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Sistemi koordinativ KRRGJSH, SIP.=37.82 Ha

Nr.	Veri	Lindje	Nr.	Veri	Lindje
1	4470315.06	559139.69	26	4469596.90	558797.04
2	4470366.50	559220.97	27	4469629.37	558836.12
3	4470379.77	559403.99	28	4469628.67	558866.74
4	4470410.48	559589.90	29	4469689.38	558987.75
5	4470415.52	559651.38	30	4469683.39	559077.42
6	4469779.03	559651.38	31	4469720.63	559164.17
7	4469724.40	559537.12	32	4469751.42	559152.34
8	4469594.16	559481.45	33	4469849.91	559087.30
9	4469520.44	559379.03	34	4469916.26	559205.78
10	4469466.16	559303.98	35	4470000.32	559182.87
11	4469428.00	559198.86	36	4469976.31	559100.65
12	4469418.24	559156.08	37	4470007.66	559100.94
13	4469465.43	559157.81	38	4470056.27	559227.37
14	4469500.64	559190.68	39	4470098.51	559225.03
15	4469540.37	559149.18	40	4470122.28	559183.50
16	4469567.67	559168.60	41	4470110.69	559138.32
17	4469607.65	559149.75	42	4470193.50	559138.73
18	4469649.51	559230.66	43	4470217.03	559144.29
19	4469675.75	559242.78	44	4470279.67	559461.66
20	4469693.28	559227.07	45	4470341.40	559521.76
21	4469604.76	558930.93	46	4470367.56	559471.03
22	4469561.57	558764.09	47	4470357.64	559324.81
23	4469575.20	558614.84	48	4470345.74	559209.41
24	4469598.57	558615.77	49	4470312.85	559157.96
25	4469576.60	558708.22			